

VENDIM
Nr.716, datë 29.10.2004

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË DHËNIES ME KONCESION TË
HIDROCENTRALEVE VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 2 të ligjit nr.8572, datë 23.9.1999 “Për privatizimin e hidrocentraleve vendore” dhe të neneve 3, 5 e 7 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së dhënies me koncesion të hidrocentraleve vendore, me fuqi deri në 2 MW, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, në përputhje me ofertat “Propozim i pakërkuar”.

2. Forma e koncesionit të jetë “ROT” (Rehabilitim-Operim-Transferim).

3. Ministria e Ekonomisë, Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit të jenë Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) për negocimin e marrëveshjes së koncesionit dhe për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion të këtyre objekteve.

4. Kriteret e vlerësimit të ofertave të pakërkua të jenë:

-Vlera e investimit (vlera më e madhe ka pikët maksimale) 40 pikë;

-Koha e kryerjes së investimit 25 pikë;

- Shkalla e rehabilitimit të makinerive dhe e pajisjeve kryesore 20 pikë;

- Rritja e prodhimit të energjisë elektrike 15 pikë.

5. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës dhe Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

Lista e 22 hidrocentraleve vendore me fuqi deri 2000 kW, që do të privatizohen nëpërmjet
“Dhënies me koncesion”

Nr.	Emërtimi	Rrethi	Fuqia e instaluar kW	Viti ndërt.	Shënime
1	Theth	Shkodër	75	1966	
2	Dragobi	Tropojë	50	1973	
3	Valbonë	Tropojë	75	1973	
4	Bradashnicë	Tropojë	25	1973	
5	Curraj i Epërm	Tropojë	50	1975	
6	Çerrem	Tropojë	35	1974	
7	Këlsyrë	Tropojë	10	1975	
8	Domaj Has	Has	27	1969	
9	Kumbull Merkurth	Mirditë	30	1967	
10	Laç Bruç	Mat	40	1966	
11	Kallavere	Dibër	125	1969	
12	Gjoricë	Bulqizë	75	1969	

13	Vinjollë	Kurbin	160	1971	
14	Labinot	Elbasan	75	1968	
15	Gjinar	Elbasan	55	1968	
16	Qarrishtë	Librazhd	50	1965	
17	Stravaj	Librazhd	100	1972	
18	Qelidhone	Korçë	120	1972	
19	Hormovë	Tepelenë	100	1976	
20	Libohovë	Gjirokastër	75	1969	
21	Fterrë	Sarandë	30	1969	
22	Lukovë	Sarandë	30	1965	